



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 260, datë 23.07.2020

PËR
PUBLIKIMIN E POZICIONEVE TË LIRA NË NIVEL APELI,
PËR GJYQTARIN ARDIAN DVORANI, QË KA TË DREJTËN E CAKTIMIT
NË NJË POZICION TË TILLË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 60, pikat 3 dhe 4, nenin 61, pika 4 dhe nenin 62, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 86, shkronja “b”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi relacionin përkatës dhe materialet e nevojshme, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Publikimin e pozicioneve të lira në nivel apeli, për gjyqtarin Ardian Dvorani, që ka të drejtën e caktimit në një pozicion të tillë, si më poshtë:
 - a) në Gjykatën e Apelit Tiranë;
 - b) në Gjykatën e Apelit Durrës;
 - c) në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë;
 - d) në Gjykatën e Apelit Korçë;
 - e) në Gjykatën e Apelit Shkodër;
 - f) në Gjykatën Administrative të Apelit.
2. Gjyqtari Ardian Dvorani ftohet për të zgjedhur njërin nga pozicionet e lira në nivel apeli sipas pikës 1, brenda datës 28 korrik 2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR